



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**  
**UJËSJELLËS KANALIZIME HIMARË SH.A**

Himarë, më 07.02.2023

**Lënda:** Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 27.01.2023.

**Z.** \_\_\_\_\_

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 27.01.2023 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1. Sa impiante për trajtimin e ujërave të ndotura ka ndërtuar Bashkia Himarë?

Trajtimi i ujërave të ndotura në qytetin e Himarës bëhet nëpërmjet vaskave të dekantimit që kanë funksionin e dekantimit të lëndës së ngurtë dhe trajtimin anaerobik. Pjesa që nuk është e lidhur me rrjetin e kanalizimeve funksionon me gropa septike personale .

2. Sa janë funksionale?

Aktualisht në Himarë është një impiant i trajtimit të ujërave të ndotura në zonën Palasë që përfshin fshatrat turistik. Ky impiant është funksional dhe shkon deri në trajtimin biologjik.

3. Cfarë kategorie është niveli i trajtimit të ujërave të ndotura?

Bashkia Himarë është pjesë dhe përfiton nga Programi i Ujësullësave Rurale IV i financuar nga KFW dhe WBIF ku në lotin 3 parashtrohet:

- Rehabilitimi dhe shtrirja e sistemit të KUN Himarë
- Ndërtimi i impiantit me trajtim mekanik biologjik
- Shkarkuesit në det pas trajtimit

Punimet e këtij projekti kanë filluar në tetor të vitit 2022. Afati kohor për përfundimin e tij është 18 muaj.

Ju faleminderit!